

## TERMA REFERENCE

### Përcaktimi i destinacioneve turistike përgjatë shtegut kryesor Egnatia në territorin e Bashkisë Elbasan dhe hartëzimi i tyre në GIS

#### 1. Informacion i përgjithshëm

Ndërhyrja “Mbështetja e fuqizimit ekonomik dhe social të grave në zonat rurale në Bashkitë Elbasanit, Kolonjës dhe Gramshit” po zbatohet nga Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural që nga shtatori i vitit 2022, si pjesë e projektit “Barazi gjinore në zonat rurale dhe turizmi” (GREAT). Ky projekt trevjeçar financohet nga Qeveria e Italisë dhe zbatohet nga UN Women dhe FAO, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në Shqipëri. Projekti synon të kontribuojë në fuqizimin e grave në zonat rurale në Shqipëri dhe të forcojë rolin dhe kontributin e tyre në zhvillimin rural, si dhe të kontribuojë drejt një zhvillimi të qëndrueshëm ekonomik për gratë e zonave rurale në bashkitë Elbasanit, Kolonjës dhe Gramshit duke rritur të ardhurat dhe aftësitë e tyre sipërmarrëse.

Një nga momentet kyçe të zbatimit të projektit ka qenë edhe themelimi i Grupit Vendor të Veprimit (GVV) “Egnatia” në bashkinë e Elbasanit, e cila është themeluar si organizatë jofitimprurëse. Shoqata është krijuar me qëllimin për të kontribuar për një zhvillim të qëndrueshëm dhe koheziv social-ekonomik në komunitetet vendore të mbuluara nga zona “Leader” përmes partneritetit lokal ndërmjet tre sektorëve: publik, operatorët ekonomikë dhe social. GVV “Egnatia” ka hartuar Strategjinë e Zhvillimit Vendor për periudhën 2024-2027, një dokument që synon zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, social dhe mjedisor të zonës “Leader” të GVV-së. Kjo zonë përputhet me kufijtë administrativë të bashkisë Elbasan, duke nxjerrë në pah edhe kohezionin e lartë gjeografik dhe administrative të saj.

Si themelimi i GVV-së, ashtu edhe hartimi i Strategjisë Lokale të Zhvillimit reflektojnë një proces animimi të territorit dhe mobilizimit të gjithë aktorëve të interesit në frymën e parimeve të metodës Leader “*Liaison Entre Actions de Développement de l’Economie Rurale*”. Leader është një metodë e zhvillimit rural, e orientuar nga poshtë-lart dhe e udhëhequr nga njerëzit në komunitet, e promovuar dhe mbështetur nga Komisioni Evropian.

#### 2. Objektivat e detyrës

ANRD në rolin e nënkontraktorit të kësaj ndërhyrje synon të mbështesë GVV “Egnatia” në zbatimin e Strategjisë së Zhvillimit Vendor. GVV “Egnatia” ka përzgjedhur një projekt të vogël për ta zbatuar dhe për të kontribuar në prioritetin e zhvillimit të turizmit rural. Projekti “*Eksploro Egnatian*” synon të krijojë një hartë digjitalë që tregon atraksionet turistike përgjatë rrugës historike Egnatia. Ky projekt ka për qëllim të promovojë atraksionet dhe destinacionet kryesore turistike brenda zonës “Leader”, veçanërisht ato që ndodhen përgjatë kësaj rruge historike. Duke rritur aksesin në këto atraksione, projekti synon të nxisë zhvillimin e turizmit rural në zonën “Leader”.

Shtegu kryesor i Egnatias në territorin e bashkisë Elbasan shtrihet në segmentin Paulesh – Mirakë në një gjatësi prej 50 km. Gjatë këtij segmenti vizitohen këto pika turistike:

- Gjurmët e rrugës Egnatia Broshkë
- At Quintum Bradashesh
- Këmbër e urës antike përroi i Kushës
- Manastiri i shën Gjonit Vladimir Shijon Bradashesh
- Ura e Topçiasit (kanali me kama)
- Kështjella e Elbasanit
- Kështjella e Menglit
- Byshek – Fushë Buall
- Kështjella e Xibrakës
- Mirakë – Ura e Kamarës

Ky projekt përfshihet në një prej objektivave strategjik të Strategjisë që synon të promovojë zhvillimin e turizmit rural në zonën “Leader”, me fokus të veçantë në krijimin e ofertave turistike përmes pikave të informacionit që ofrojnë detaje mbi zonat vendore, atraksionet dhe aktivitetet turistike të disponueshme.

Për këtë arsye, ANRD po kërkon një subjekt të regjistruar, të kualifikuar për të përcaktuar destinacionet turistike të lokalizuara përgjatë shtegut kryesor Egnatia që shtrihet në territorin e Bashkisë Elbasan dhe për t’i hartëzuar ato në GIS. Produkti final i pritshëm do të jetë një hartë digjitale të pikave kryesore turistike përgjatë shtegut Egnatia, e cila është e aksesueshme nga vizitorët dhe turistët duke mbështetur zhvillimin e turizmit rural në zonën e Leader.

### 3. Përgjegjësitë dhe detyrat

Nën mbikëqyrjen e Menaxherit të Projektit të ANRD dhe në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorin Ekzekutiv të GVV Egnatia, kompania do të jenë përgjegjës për:

1. *Identifikimin e destinacioneve/atraksioneve turistike përmes vizitave në terren për të identifikuar dhe dokumentuar atraksionet përgjatë shtegut historik të Egnatias.* Procesi do të përfshijë dokumentimin përmes fotove dhe përshkrimin e atraksioneve të dhënat e mundshme për t’u mbledhur, përfshijnë (jo shteruese): koordinatat gjeografike, përshkrimet të atraksioneve, informacione historike dhe kulturore, niveli i aksesueshmërisë etj.
  - *Vlerësimi dhe përcaktimi i atraksioneve që do të hartëzohen në sistemin GIS.* Bazuar në informacionin e grumbulluar, kompania do të vlerësojë potencialet për zhvillimin e turizmit të secilit prej tyre duke përdorur disa kritere bazë. Atraksionet me prioritet më të lartë për zhvillim ekonomik të komuniteteve rurale do të përbëjnë listën e atraksioneve që do të hartëzohen në GIS.
  - *Hartëzimi në GIS i atraksioneve të përzgjedhura në bazë të potencialit të tyre për zhvillimin e turizmit.* Hartëzimi do të përfshijë krijimin e një harte interaktive, ku çdo atraksion do të jetë i lokalizuar me të dhëna të detajuara për t’u aksesuar nga përdoruesit e hartës.
  - *Subjekti do të bashkëpunojë me Drejtorin Ekzekutiv të GVV Egnatia dhe ekipin e ANRD, për të siguruar që shërbimi të realizohet me standarde të larta dhe në përputhje me qëllimet e projektit.* Për këtë kompania do të duhet të mbajë një komunikim të vazhdueshëm dhe të rregullt mbi ecurinë e detyrës.

### 4. Produktet dhe afatet kohore

Produktet dhe afatet e dorëzimit të tyre janë si më poshtë:

Produktet	Afati
1. Lista e atraksioneve të përcaktuara për t’u hartëzuar në GIS (bazuar në vlerësimin e potencialeve të tyre)	20 ditë pune pas nënshkrimit të kontratës
2. Hartëzimi në GIS i atraksioneve dhe broshura elektronike me informacionet përkatëse për çdo atraksion (Produkti final i aprovuar nga ANRD)	20 tetor 2024

Kontrata pritet të fillojë menjëherë pas nënshkrimit të kontratës.

Pagesa do të bëhet në një kësht, pasi të dorëzohet produkti përfundimtar dhe të paraqitet fatura tatimore nga subjekti i kontraktuar. Të gjitha dorëzimet do të paraqiten në format elektronik tek Menaxheri i Projektit, i cili është përgjegjës për të shqyrtuar dhe kërkuar rishikime për versionet e paraqitura dhe për të certifikuar dorëzimin e produktit përfundimtar.

Fondi limit për këtë shërbim është 327,500.00 Lek.

**5. Kualifikimet që kërkohen për këtë detyrë:**

- a) Subjekti/eksperti duhet të ketë përvojë pune të mëparshme në hartëzimin e destinacioneve turistike dhe përdorimin e GIS.
- b) Të ketë minimumi 3-5 vjet përvojë pune në projekte të ngjashme;
- c) Të ketë ekspertizë në përdorimin e GIS, krijimin e hartave GIS, analizë gjeo-hapësinore, si dhe zhvillimin e turizmit.
- d) Njohuri të mira territoriale në nivelin e Bashkisë Elbasan si dhe shtegut historik të Egnatia, duke përfshirë edhe atraksioneve turistike në këtë zonë.
- e) Të zotërojë të gjitha licencat e nevojshme për kryerjen e shërbimeve të kërkuara.
- f) Përvojë të mëparshme pune me bashkinë e Elbasanit apo aktorët kyç të GVV Egnatia konsiderohet vlerë e shtuar.

**6. Procedura e Aplikimit**

Aplikantët e interesuar ftohen të dorëzojnë aplikimin për këtë angazhim jo më vonë se data 2 shtator 2024, ora 17:00, në adresën email: [info@anrd.al](mailto:info@anrd.al).

Aplikimi duhet të përfshijë një profil të subjektit, dokumentet e regjistrimit, bio e shkurtër, CV e stafit që do të angazhohet dhe propozimin financiar në Lek. Propozimi financiar duhet të specifikojë shumën totale të kërkuar për përmbushjen e angazhimit duke përfshirë te gjitha taksat e lidhura me këtë shërbim.